




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

PRISHTINA



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 4, neni 7 dhe neni 8, paragrafi 5 të Ligjit nr. 03 / L-139, për shpronësimin e pronës së paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin nr. 03/L-205, të datës 28.10.2010 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 91) dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr: 110-391, dt. 25.02.2010, pas kërkesës së Drejtorisë së Pronës për iniciimin e procedurës së shpronësimit, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës së Drejtorisë së Pronës për shpronësimin e pronës së paluajtshme, parcelës kadastrale nr. P-71914059-01850 - 1, me sipërfaqe 3217 m², në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit, e cila shtrihet në Zonën kadastrale Prishtinë, ku sipas Planit rregullues "Kalabria" të Komunës së Prishtinës, është paraparë: infrastrukturë rrugore dhe ndërtim i kolektorit.
- II. Vlera e kompensimit të pronës së cekur në pikën I, caktohet nga Zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Pronës, Drejtoria e Kadastrit, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, dhe Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.
- IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërin nga gazetatat me tirazh të madh.
- V. Pjesë e këtij Vendimi është Lista e përshkrimit detaj të parcelës kadastrale të paraparë për shpronësim.

U dorëzohet:

- Drejtorisë së Pronës;
- Drejtorisë së Urbanizmit;
- Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;
- Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave;
- Drejtorisë së Financave;
- Drejtorisë së Kadastrit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

Kryetari i Komunës
Shpend Ahmeti

